

# Brifingu

minority  
rights  
group  
international



**SONCE**  
Roma Democratic  
Development Association

## **Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë**

Andrea Spitàlszky





## Fëmiju në vendbanimin rome, Republika e Maqedonisë.

Andrea Spitalszky, prill 2018.

### Mirënjohje

Projekti: Nga veprimi drejtë të drejtave të barabarta të romëve. IPA/2015/382006. Ky botim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës për Zhvillim Demokratik të Romëve SONCE dhe organizatës "Minority Rights Group International" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

### Shoqata për Zhvillim Demokratik të Romëve SONCE

Shoqata për Zhvillim Demokratik të Romëve SONCE është organizatë joqeveritare që vepron në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të avancuar integrimin qytetar, të drejtat demokratike dhe mundësitë e barabarta për romët në Republikën e Maqedonisë. E themeluar në vitin 1996 si një grup i pavarur për komunitetin romë në Komunën e Tetovës dhe zyrtarisht e regjistruar si organizatë jo për fitim në vitin 1999, SONCE ka zbatuar më tepër se 50 projekte gjatë dy dekadave të fundit në fusha të që përfshijnë arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, punësimin dhe pjesëmarrjen demokratike të Romëve.

SONCE bashkëpunon ngushtë me organizatat tjera të shoqërisë qytetare, institucionet publike dhe grupet ndërkombëtare me qëllim sjelljen e ndryshimeve pozitive në komunitetin romë. Ajo është anëtare e rrjeteve dhe trupave kombëtare dhe ndërkombëtare në vijim: Rrjeti për Avokimin e të Drejtave të Romëve, Trupi Koordinues Kombëtar Pas Zbatimit të Strategjisë së Romëve 2014 -2020, Unioni Federal i Kombësive Evropiane (FUEN) dhe të Bashkuar Kundër Racizmit.

### Organizata 'Minority Rights Group International'

Organizata 'Minority Rights Group International (MRG)' është organizatë joqeveritare (OJQ) që vepron në sigurimin e të drejtave të minoriteteve etnike, fetare dhe linguistike si dhe popujve indigjen anembanë botës, si dhe avancimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve. Aktivitetet tona përqendrohen në avokimin, trajnimin, botimin dhe përkrahjen ndërkombëtare. Ne udhëhiqemi nga nevojat e shprehura nga rrjeti botëror i organizatave partnere, të cilat i përfaqësojnë popujt minoritar dhe indigjen.

MRG bashkëpunon me mbi 150 organizata në rreth 50 shtete. Këshilli ynë Drejtues, i cili takohet dy herë në vit, përbën anëtarë nga 10-të shtete të ndryshme. MRG ka status konsultativ në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), si dhe statusin e vëzhguesit në Komisionin Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (ACHPR). MRG është regjistruar si shoqëri bamirëse dhe me përgjegjësi të kufizuara sipas ligjeve angleze: shoqëria bamirëse e regjistruar nr. 282305, shoqëria me përgjegjësi të kufizuara nr. 1544957.

© Minority Rights Group International 2018

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Materiali i këtij botimi mund të riprodhohet për mësimdhënie ose për qëllime të tjera jo komerciale. Asnjë pjesë e tij nuk mund të riprodhohet në asnjë formë për qëllime komerciale pa lejen e qartë paraprake të bartësve të të drejtës së autorit. Për më tepër informacione ju lutem kontaktoni MRG. Një regjistrim katalogësh CIP për këtë botim është i qasshëm në Bibliotekën Britanike.

ISBN 978-1-912938-04-9. Botuar nëntor 2018.

Përkthim në shqip: KONSONANT ND DOOEL- Gostivar.

**Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë** është botuar nga MRG si një kontribut për të kuptuarit publik rreth çështjes së botimit. Teksti dhe pikëpamjet e autorit nuk e përfaqësojnë domosdoshmërisht, në çdo hollësi dhe në të gjitha pikëpamjet e tij, pikëpamjen kolektive të MRG-së.

# Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë

## Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm i referohemi Maqedonia) popullsia rome ende paraqet minoritetin më të cenueshëm në vend, një komunitet që përballet edhe me diskriminim institucional edhe me paragjykime shoqërore. Ky raport ofron njohuri të rëndësishme për jetën e përditshme të romëve të Maqedonisë. Ai mbështetet në njohuritë e dorës së parë të grumbulluara nga ndërmjetësit romë duke punuar me komunitetin e tyre, në këtë mënyrë duke iu mundësuar romëve që vetvetiu të shprehën dhe përshkruajnë përvojën e drejtpërdrejtë me pengesat që i përjetojnë.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë së vitit 2002, 53,879 banorë (2.7 për qind) janë deklaruar si romë, megjithëse numri i vërtetë mund të jetë shumë më i madh: për shembull, Këshilli i Evropës ka vlerësuar që ekzistojnë ndërmjet 134,000 dhe 260,000 romë në vend.<sup>1</sup> Përkundër njohjes zyrtare – romët shprehimisht përmenden si komunitet minoritar në Preambulën e Kushtetutës së Maqedonisë, e cila u ndryshua sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në vitin 2001<sup>2</sup> - romët mbeten të përjashtuar nga shoqëria kryesore dhe përjetojnë diskriminim në pothuajse çdo pikëpamje të jetës.

Ky proces ka filluar që më herët, me ndarjen e shumë fëmijëve romë në klasa të veçanta ose madje edhe në shkolla të veçanta, në të cilat programi mësimor është shpeshherë i cilësisë më të dobët, ndërsa nxënësit rrjedhimisht kanë rezultate të më të ulta akademike. Për arsye të llojllojshme, norma e braktisjes së shkollimit është më e lartë në mesin e romëve krahasuar me popullsinë e përgjithshme dhe kjo, në kombinim me diskriminimin në tregun e punës, pamundëson që pjesa dërmuese e romëve të gjej punë zyrtare. Si rrjedhojë, pjesa dërmuese e romëve jetojnë në kushte jetësore nën standardet, shpeshherë duke luftuar me mbipopullsinë dhe pa qasje në higjienë publike, ujë të pijshëm të sigurt, energji elektrike, ndriçim rrugor ose transport publik.

Gjatë pjesëmarrjes së saj në Dekadën e Gjithpërfshirjes së Romëve të viteve 2005-2015, Qeveria miratoi Strategjinë e saj të parë për romët,<sup>3</sup> e cila synonte të përmirësojë cilësinë e jetës së romëve, zvogëlojë pabarazitë, zgjerojë qasjen në shërbime dhe të avancojë integrimin. Dhjetë vjet më vonë, në pajtim me Kornizën e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve dhe me përgatitjen për peridudhën kohore pas Dekadës së Romëve, Qeveria miratoi një strategji të re, e cila përqendrohet në pesë fusha prioritare: arsim, shëndetësi, punësim, strehim dhe kulturë.<sup>4</sup> Aktualisht, edhe përkundër një përparimi të

caktuar, në fushat siç janë regjistrimi në shkolla dhe zbatimi i strategjisë mbeten në nivel të ulët.<sup>5</sup>

Ky raport, duke u mbështetur në punën e gjerë në terren dhe në hulumtim, përqendrohet në tri fusha kryesore në të cilat romët vazhdojnë të përjetojnë diskriminim të thellë: në arsim, strehim dhe shëndetësi. Qëllimi i raportit është të shërbejë si një vegël e fuqishme për avokim në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke i bashkuar informacionet e grumbulluara në terren nga ndërmjetësit për të mbështetur organizatat e shoqërisë qytetare (OshQ) dhe aktivistët për të drejtat e njeriut në punën e tyre. Ai po ashtu siguron informacione për vendimmarrësit kombëtar dhe ndërkombëtar rreth gjendjes së romëve. Më e rëndësishmja, shpresohet që ky botim do të fuqizojë komunitetin romë në luftën e tyre për drejtësi sociale dhe barazi.

## Metodologjia

Ky raport buron nga bashkëpunimi ndërmjet organizatës Minority Rights Group International (MRG) dhe Shoqatës për Zhvillim Demokratik të Romëve (ang. RDDA) SONCE si pjesë përbërëse e një projekti të përbashkët tri-vjeçar, 'Nga veprimi drejtë të drejtave të barabarta të romëve' (2017-2020), i financuar nga BE-ja. Qëllimi i këtij projekti është të luftojë diskriminimin që e përjetojnë romët në Maqedoni nëpërmjet procedurave gjyqësore, avokimit dhe ngritjes së kapaciteve. Si pjesë përbërëse të këtyre aktiviteteve, në maj të vitit 2017 organizata MRG dhe RDDA SONCE aftësuan 31 ndërmjetësues romë në temën e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, diskriminimin, avokimin dhe përkrahjen e komunitetit. Qysh atëherë, 12 ndërmjetësues prej tyre kanë punuar rregullisht në këtë projekt duke i vizituar gjashtë komunat e synuara (Tetovën, Dibrën, Kërçovën, Shtipin, Vinicën dhe Berovën) në bazë javore për të takuar pjesëtarët e komunitetit romë, për të marr shënime për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të identifikuar incidente për procedurë gjyqësore dhe avokim. Gjetjet e tyre, bazuar në udhëtimet në terren ndërmjet qershorit të vitit 2017 dhe janarit të vitit 2018, u shfrytëzuan si bazë për këtë raport.

Përveç raporteve të përpiluara nga ndërmjetësit, MRG dhe RDDA SONCE realizuan hulumtime për të grumbulluar të dhëna të rëndësishme statistikore dhe informacione mbi legjislacionin kombëtar, si dhe biseduan me pjesëtarët e komunitetit romë në kartë komunat e

synuara gjatë vizitave të tyre në terren në prill të vitit 2018. Gjithashtu, partnerët u mbështetën në Planin e Veprimit për Avokim të Rjetit për Avokim të Romëve,<sup>6</sup> i cili përqendrohet në të tri fushat që i trajton ky raport.

## Diskriminimi: shkaku kryesor i shkeljeve të të drejtave të njeriut

Mos diskriminimin dhe barazinë e garanton ligji dhe Kushtetuta e Maqedonisë,<sup>7</sup> ndërsa u forcua edhe më tej me miratimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në vitin 2001, e cila e garanton parimin e përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë të komuniteteve.<sup>8</sup> Në vitin 2010, u miratua Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi,<sup>9</sup> i cili i përcakton llojet e ndryshme të diskriminimit dhe rrjedhimisht u formua Komisioni për Mbrojtje kundër Diskriminimit.<sup>10</sup> Komisioni posedon kompetenca të llojllojshme në fushën e antidiskriminimit, vepron sipas parashtrësave dhe jep mendime dhe rekomandime në raste të diskriminimit.<sup>11</sup> Për më tepër, Avokati i Popullit luan një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e parimit të mos diskriminimit.<sup>12</sup> Për shembull, në vitin 2017, nga 3,223 parashtrës të dorëzuara Avokatit të Popullit, 1,871 qytetarë e kishin deklaruar prejardhjen e tyre etnike, nga të cilët 117 ishin të përkatësisë rome.<sup>13</sup> Parashtrësat e dorëzuara nga ankuesit romë kishin të bëjnë kryesisht me shëndetësinë, mirëqenien sociale, financat, të drejtat e konsumatorit, gjyqësorin, të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin urban.<sup>14</sup>

Përkundër mbrojtjes ligjore dhe institucionale tashmë në fuqi, diskriminimi mbetet një realitet i përditshëm për romët. Që nga moshën e hershme ata përjetojnë paragjykimet dhe mospranim nga pjesa dërmuese e shoqërisë. Në të vërtetë, pjesa dërmuese e romëve luftojnë për të gëzuar tërësisht të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale, përfshi dhe të drejtën për arsim, punësim, strehim dhe shëndetësi të përshtatshme. Romët që nuk kanë dokumente personale e gjejnë veten në marginat e shoqërisë, në rrezik të pashtetësisë, me shumë pak qasje në shërbime themelore. Për shkak të të dhënave statistikore të pakompletuara, është vështirë të vlerësohet numri i romëve pa shtetësi. Sipas vlerësimeve të Shoqatës Maqedonase të Avokatëve të Ri, ekzistojnë 664 persona në rrezik të pashtetësisë, ndërsa 70% prej tyre janë romë.

Romët e kthyer (nga jashtë) po ashtu janë më shumë të cenueshëm dhe zakonisht përballesh me vështirësi për t'u reintegruar. Pas liberalizimit të vizave në vitin 2009, për shkak të kushteve të pafavorshme ekonomike dhe marginalizimit social, mijëra romë kërkuar azil në vendet anëtare të BE-së. Pjesa dërmuese e njerëzve që e braktisën Maqedoninë për të jetuar në shtetet e jashtme, kryesisht në Gjermani, Francë, Belgjikë, Holandë dhe Suedi, ishin romë. Mirëpo, shumicës së azil kërkuarëve nga Maqedonia, përfshi dhe romët, i janë refuzuar kërkesat e tyre nga

vendet anëtare të BE-së dhe kërkuarët e pasuksesshëm janë kthyer në Maqedoni.

Një ndër rastet më të zakonshme të diskriminimit të identifikuar nga ndërmjetësit romë është qasja në shërbimet private. Një numër i caktuar incidentesh janë evidentuar lidhur me parandalimin e romëve për të hyrë në restorante, kafene, diskoteka, pishina ose hotele për shkak të një llojllojshmërie të arsyeve të rreme: për shembull, iu thonë se po organizohet një ngjarje private ose se kanë nevojë për rezervim, madje kur edhe hapësirat janë të zbrazura. Në raste tjera, darkuesit përpiqen të qëndrojnë sa më larg tyre ose iu adresohen fyerje ose nga kamerierët ose nga mysafirët e tjerë. Shpeshherë kamerierët refuzojnë ti shërbejnë romët dhe në rastet më të skajshme, i njoftojnë drejtpërdrejtë se nuk pranojnë romë.

Për shembull, në një komunë, ndërmjetësit raportuan një rast ku një grua rome, e cila kishte shkuar në një park uxor me fëmijët e saj. Pasi që i kishte blerë biletat, një punonjës i kishte ndaluar në hyrje dhe i kishte kontrolluar çantat e shpinës – diçka që asnjë familje tjetër në park nuk ishte e obliguar për ta bërë – dhe iu kishte bërë titur që t'i kthejnë biletat dhe të largohen. Ky incident qartazi tregon se si profilizimi etnik dhe paragjykimet ndikojnë në gjendjen e romëve. Përveç diskriminimit, gjë që është e ndaluar me ligj, këto përjetime kanë efekte të fuqishme negative mbi vetëbesimin dhe besimin e tyre në shoqëri.

## Arsimi

Kushtetuta e Maqedonisë<sup>15</sup> dhe Ligji për Arsimin Fillor<sup>16</sup> e garanton të drejtën për arsim nën kushte të barabarta. Megjithatë, fëmijët romë ende po vuajnë nga stigma shoqërore, diskriminimi dhe segregimi,<sup>17</sup> si dhe ballafaqohen me disa pengesa për qasjen e tyre në formim dhe arsim të rregullt dhe cilësor.<sup>18</sup> Regjistrimi i nxënësve parashkollor i fëmijëve romë ende është shumë i ulët: një hulumtim për një vendbanim të përzgjedhur romë zbuloi se vetëm 14% e fëmijëve romë në moshën 3-6 vjeç vijon arsim parashkollor, krahasuar me 20% të popullsisë jo rome që jeton në afërsi.<sup>19</sup> Gjithashtu, ekziston vijim i ulët i mësimi dhe norma të larta të braktisjes së shkollimit në mesin e nxënësve romë. Ekzistojnë disa arsye për këtë: migrimi i familjeve rome në vendet e Evropës Perëndimore, mungesa e dokumenteve personale, segregim madje edhe në fazat më të hershme të arsimit, si dhe mungesa e transportit të organizuar ose publik nga vendbanimet rome në çerdhe, të cilat shpeshherë janë shumë larg nga institucionet arsimore.<sup>20</sup> Nga të gjitha grupet etnike në Maqedoni, niveli i analfabetizimit është më i lartë te romët: mirëpo, ka pasur disa shenja përmirësimi në regjistrimin dhe mbarimin e shkollimit në mesin e nxënësve romë në arsimin fillor dhe të mesëm.<sup>21</sup>

Në bazë të raporteve të ndërmjetësve, në disa raste fëmijët romë duhej të vijonin mësimin në klasa të ndara ose fizikisht largohen nga moshatarët e tyre jo romë brenda

klasës dhe janë të detyruar të ulen në bankat e fundit. Përpjesëtimi i fëmijëve romë të marginalizuar që e vijnë në mësimin e segreguar është shumë i madh, me 40% të nxënësve romë të marginalizuar në moshën 7-15 vjeçe vijnë në mësimin e ndarë në vitin 2017. Është shqetësues fakti që kjo dukuri duket që është në rritje: në vitin 2011, ky përpjesëtim ishte 25 %. Cilësia e arsimit në këto shkolla zakonisht është e dobët dhe me burime të kufizuara dhe me kuadër arsimor me më pak cilësi.<sup>22</sup> Në bazë të Ligjit për Arsimin Fillor, shkollat fillore janë të detyruara të regjistrojnë nxënësit që banojnë në zonën e tyre: mirëpo, një shkollë fillore mund të regjistrojë nxënësit edhe nga zonat tjera të komunës në qoftë se ka vende të lira, e cila gjë shpeshherë shpie në arbitraritetin e kësaj praktike.<sup>23</sup> Një ndër arsyt kryesore që qëndron prapa segregimit në shkolla është ajo se prindërit gjejnë mënyra për të shmangur sistemin zonal të shkollave për të siguruar vende për fëmijët e tyre në shkollat që i parapëlqejnë – një gjendje që kontribuon në krijimin e shkollave fillore ‘vetëm për romët’. Avokati i Popullit, në mënyrë të përsëritur, e ka theksuar çështjen e segregimit dhe të përfaqësimit jo të barabartë të fëmijëve romë në shkolla të veçanta.<sup>24</sup>

Varfëria është edhe një pengesë tjetër ndaj arsimimit: pjesa dërmuese e prindërve romë nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të blerë rroba, këpucë ose material shkollor për fëmijët e tyre. Pasi që disa nga amvisëritë rome më të varfra nuk kanë qasje në ujë, që e vështirëson higjienën, prindërit mund të pëcaktohen që të mos i dërgojnë fëmijët në shkollë për shkak të ngacmimit nga moshatarët e tyre. Shumë familje rome, po ashtu, largohen për punë sezonale me fëmijët e tyre, të cilët pastaj mungojnë në shkollë gjatë asaj periudhe. Në disa familje tradicionale, vajzat inkurajohen të qëndrojnë në shtëpi që të ndihmojnë me punët e shtëpisë dhe të kujdesen për vëllezërit ose motrat e tyre më të vegjël sesa të vijnë në mësimin.<sup>25</sup> Disa fëmijë, po ashtu, nuk kanë dokumente të nevojshme që të mund të regjistrohen në shkollë ose të pranojnë dëftesa. Romët nganjëherë ndalohen të regjistrohen ose nuk kanë njohuri të plotë për të drejtat e tyre të garantuara me ligj.

Më tutje, fëmijët romë dhe prindërit e tyre shpeshherë i nënshtrihen diskriminimit, ngacmimit, keqtrajtimit ose formave të tjera të keqtrajtimit në shkollë. Ndërmjetësit romë kanë raportuar disa raste kur fëmijët romë i janë nënshtruar paragjyqimeve dhe armiqësisë nga moshatarët e tyre, madje edhe nga mësimdhënësit e tyre, përfshi fyerje ose vlerësim me nota më të dobëta për qëllime diskriminuese. Ndërmjetësit romë kanë raportuar raste të fëmijëve romë që kanë qenë të detyruar të ulen në bankat e fundit të klasës dhe të mos e kenë vëmendjen e e njëjtë të mësimdhënësve sikur e kanë moshatarët e tyre jo romë. Në një shkollë të caktuar, nxënësit romë, për dallim nga moshatarët e tyre jo romë, menjëherë ndëshkohen në mënyrë fyese: në qoftë se nuk kanë sjellje të mirë, për shembull, ata duhet të qëndrojnë në një këmbë për një orë të tërë.

Për ata fëmijë romë, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha maqedone, është edhe më vështirë të vijnë në mësimin

dhe të integrohen në shkollë. Megjithatë Ligji për Arsimin Fillor garanton që gjuha dhe kultura rome mund të mësohen si lëndë zgjedhore, në praktikë kjo dispozitë anashkalohet në masë të madhe, ndërsa shpeshherë kjo alternativë nuk është në dispozicion të nxënësve romë. Për më tepër, ekziston mungesë e kuadrit të kualifikuar mësimor romë në shkollat fillore dhe të mesme, ndërsa njëkohësisht mësimdhënësit romë që janë të kualifikuar dhe kanë mbaruar studimet universitare nuk mund të gjejnë punë në shkollat fillore dhe të mesme. Më tutje, fëmijët e romëve të kthyer përballen me vështirësi për t’u integruar dhe për t’ju njohur diplomat e tyre në Maqedoni, të cilat i kanë fituar në shkollat e huaja. Në vazhdim, ekzistojnë pasoja financiare, sidomos në familjet me më tepër fëmijë, prindërit shpeshherë nuk mund të paguajnë për taksat administrative.<sup>26</sup> Përveç pengesave gjuhësore, atyre iu mungon edhe përkrahje psikologjike, emocionale dhe sociale për t’u ballafaquar me tronditjen kulturore pas kthimit në vend.

## Strehimi

Ekzistojnë ligje të llojllojshme në Maqedoni, të cilat e rregullojnë strehimin dhe të cilat janë të rëndësishme vetëm për romët, sikur është Ligji për Strehim<sup>27</sup> dhe Ligji për Procedurën e Godinave të Ndërtuara në mënyrë të paligjshme.<sup>28</sup>

Romët ballafaqohen me kushtet më të vështira për strehim në Maqedoni.<sup>29</sup> 28 për qind e romëve jetojnë në lagje të varfra, në shtëpi të ndërtuara keq, të cilat shpeshherë janë të palegalizuara.<sup>30</sup> Mbipopullimi është po ashtu në dukje: shumë familje rome jetojnë në shtëpi me më pak se 5 m<sup>2</sup> për person.<sup>31</sup> Kjo gjendje është përkeqësuar nga paqartësia e këtyre aranzhimeve, me rreth 80,000 amvisëri rome që iu mungon zgjidhje afatgjate për strehim.<sup>32</sup> Mungesa e shpeshtë e ujit të pijshëm, energjisë elektrike, ngrohjes ose kanalizimit po ashtu kontribuon në përhapjen e shëndetit të lig.

Agjencitë e vetëqeverisjes lokale luajnë një rol të rëndësishëm pasi që ato e kanë mandatin që për së afërmi ta rregullojnë çështjen e strehimit. Ato janë përgjegjës për zhvillimin e infrastrukturës, planifikimin urbanistik dhe regjistrimin e tokës, mirëpo shumë romë nuk kanë njohuri për strukturat e ndërlikuara institucionale që i krijojnë këta politika dhe prandaj në masë të madhe varen nga vullneti i mirë i vendimmarrësve. Sipas raporteve, përdërisa janë bërë rreth 2,000 kërkesa për legalizimin e objekteve viteve të fundit, rezultatet e asaj procedura nuk janë të njohura – megjithatë organizatat e shoqërisë qytetare besojnë që koeficienti duhet të jetë relativisht i ulët në nivel kombëtar.<sup>33</sup> Në këtë drejtim, është e vështirë për qytetarët, veçanërisht romët, që të kenë një pasqyrë të qartë për legalizimin dhe si mund të zhillohet kjo procedurë me sukses në të ardhmen.

Më tutje, organizatat e shoqërisë qytetare theksojnë se Programi Kombëtar për Strehime Sociale ka dështuar të

arrijë ato zona në të cilat popullsia rome ka më tepër nevojë për këto masa, dhe se nuk ekzistojnë strehime sociale të mjaftueshme për t'u kujdesur për të gjithë ata që kanë nevojë. Madje edhe në rajonet ku vëllimi i strehimit social në dispozicion është në përpjesëtim me numrin e romëve,

ata shpeshherë janë të pavetëdijshëm për këto alternativa dhe për procedurat e përfshira për të parashtruar kërkesa. As plane detale urbanistike nuk kanë të gjitha vetëqeverisjet lokale, e cila gjë e pengon edhe më tej zbatimin e Programit për Strehime Sociale.<sup>34</sup>

## Ndikimi i kushteve të dobëta të jetesës mbi shëndetin dhe arsimin e romëve

Disa vite më parë, pasi që një përmytje në Maqedoninë lindore e shkatërroi një vendbanim romë, banorët u zhvendosën në një parcelë të një ish-spitali. Këto ndërtesa ishin në gjendje të mjerueshme dhe nuk ishin të përshtatshme për banimin e njerëzve: pasi që mungonin mobilie më themelore, siç ishin shtretërit, shumica e romëve janë të detyruar të flejnë në dysheme me fëmijët e tyre, të mbuluar vetëm me batanije. Pasi që nuk ka shporta për mbetje, plehërat grumbullohen në oborr dhe joshin insekte: disa fëmijë u infektuan si rrjedhojë. Pasi që shumica e atyre që jetojnë aty nuk kanë të ardhura dhe nuk mund të paguajnë për koston e energjisë elektrike, shpeshherë janë pa qasje në energji elektrike. Fëmijët nuk janë në gjendje të vijnë në mësimin dhe nuk kanë as rroba të përshtatshme ose ujë për të pastruar veten. Vetëqeverisja lokale ka premtuar se do të gjej zgjidhje, por asgjë nuk është bërë deri më tani.

Gjendja gjithashtu është shqetësuese edhe në një vendbanim tjetër romë, të cilin e vizituan personeli i organizatave MRG dhe RDDA SONCE së bashku me ndërmjetësit romë në prill të vitit 2018. Pjesa dërmuese e

shtëpive nuk kanë mandat ligjor: nga rreth 30 familje që e nisën procedurën e legalizimit, vetëm pesë prej tyre kanë pasur sukses të legalizojnë shtëpitë e tyre, ndërsa të tjerët ende presin të pranojnë vendime pozitive për lëndët e tyre. Familjet tjera nuk kanë mjete financiare për të filluar me procedurën e legalizimit. Shumica e shtëpive nuk kanë as higjienë publike ose ujë të rrjedhshëm: megjithëse pushteti lokal ndërtoi një rezervuar një vit më parë, prapë se prapë shpeshherë nuk ka ujë, ndërsa banorët e shfrytëzojnë një të vjetër që është ndërtuar 25 vite më parë. Mirëpo, cilësia e ujit nuk është e mirë dhe shumë njerëz pohojnë se janë sëmurë. Kur rezervuari është i thatë, ato familje që mund ta përballojnë blejnë ujë në shishe, ndërsa familjet më të varfra duhet të shkojnë deri te pompa më e afërt, rreth 200 metra larg, për të marr ujë. Pasojat negative nga kjo qasje e kufizuar – për shemull, banorët duhet t'i lajnë rrobat e tyre me dorë dhe nuk kanë mundësi për të bërë dush – ndikojnë edhe në fushat e tjera të jetës së romëve. Nxënësit romë ballafaqohen me diskriminim dhe keqtrajtim nga mësimdhënësit për shkak të, asaj që mund të perceptohet, higjienës së dobët personale.

## Shëndetësia

Kushtetuta e Maqedonisë e garanton të drejtën për shëndetësi për të gjithë qytetarët.<sup>35</sup> Ndalimi i diskriminimit për çdo arsye në shëndetësi është e garantuar me Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit<sup>36</sup> dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve,<sup>37</sup> mirëpo në praktikë diskriminimi në shëndetësi ndaj romëve ende është i përhapur dhe mbetet i padenoncuar në masë të madhe. Përvoja negative të cilën e kalojnë shumica kur përpiqen të kenë qasje në shëndetësi mund t'i shkurajoj ata që të shfrytëzojnë këto shërbime në të ardhmen.

Sipas legjislacionit kombëtar, të gjithë qytetarët kanë të drejtë për sigurim shëndetësor<sup>38</sup> ndërsa sigurimi në mesin e romëve është më i miri në rajon<sup>39</sup> dhe është pranë të përgjithshmes: 94 për qind e romëve të marginalizuar (të moshës 16+) janë të siguruar, në krahasim me 97 për qind e popullsisë jo rome që jeton në afërsi.<sup>40</sup> Arsyeya kryesore për ata që nuk kanë sigurim shëndetësor është mungesa e dokumenteve personale. Megjithatë, ndërsa sigurimi shëndetësor i romëve është i krahasueshëm me atë të popullsisë jo rome, shërbimet që romët i pranojnë zakonisht

janë të cilësisë më të ulët se sa shërbimet që i ofrohen popullsisë së përgjithshme.<sup>41</sup> Më tutje, te romët, normat e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë janë më të larta se sa te popullsia e përgjithshme:<sup>42</sup> Kjo ndikon tepër në jetëgjatësinë mesatare më të ulët të romëve (68 vjet) krahasuar me mesataren e popullsisë së përgjithshme (73.5 vjet).<sup>43</sup>

Diskriminimi nga personeli mjekësor ndaj romëve luan një rol të rëndësishëm për mosdashjen e tyre të shkojnë te mjeku. Përveç pengesave kulturore ekzistuese, punonjësit shëndetësor shpeshherë kanë sjellje armiqësore ndaj pacientëve romë ose bëjnë komente raciste për ta. Kjo sjellje, bazuar në stigmatizim dhe paragjykim, shpeshherë i largon romët të kërkojnë kujdes mjekësor – gjë që kontribuon në rezultate shëndetësore të dobëta. Për shembull, një hulumtim zbuloi se pothuajse përqindja e njëjtë e romëve vuan nga sëmundje kronike jo ngjitëse sikurse dhe popullsia jo rome, mirëpo një përqindje e ulët e tyre ka pranuar terapi të rregullt, ndërsa ata që kanë pranuar terapi kanë pranuar shërbime shëndetësore të cilësisë më të ulët.<sup>44</sup> Ngjashëm, një përqindje e vogël e

fëmijëve romë janë vaksinuar në krahasim me fëmijët e grupeve tjera etnike.<sup>45</sup> Zgjidhja për këtë pjesërisht varet nga përfshirja më e mirë sociale e komunitetit romë: në veçanti, ndërmjetësit shëndetësor romë<sup>46</sup> luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e informacioneve dedikuar romëve për të drejtat e tyre shëndetësore, gjë që do të kontribuonte në mbulimin më të gjerë me siguri shëndetësor dhe vaksinim të fëmijëve.<sup>47</sup>

Gratë rome janë në veçanti të cenueshme pasi që përballen edhe me pengesa fizike dhe financiare për të pasur qasje në shëndetësinë primare gjinekologjike. Shpeshherë, ata jetojnë në vendbanime të largëta pa asnjë transport publik ose gjinekologu i ngarkon me pagesë për shërbimet që ndryshe duhet të jenë falas. Shumë gra rome

nuk pranojnë asnjë lloj edukimi shëndetësor dhe prandaj nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre. Ndërmjetësit e organizatës MRG kanë raportuar, në disa raste, se gratë rome kanë pasur vështirësi në caktimin e takimit me gjinekologun amë. Kur kanë shkuar për të caktuar takim, iu është thënë që mund të pranojnë vetëm një takim në dy javë, përderisa kanë qenë dëshmitare të caktimit të takimeve për gratë e popullsisë jo rome për ditën e ardhshme. Të gjithë këto faktorë kontribuojnë në mosdashjen e grave rome për të vizituar gjinekologun e tyre që të kenë kontrollë parandaluese, dhe kështu e vënë shëndetin e tyre në rrezik: shumica e tyre nuk i vizitojnë as gjinekologët e tyre gjatë shtatzënisë, ndërsa në disa raste lindin në shtëpitë e tyre, pa asnjë përkujdesje mjekësore.<sup>48</sup>

## Paragjykimet dhe diskriminimi në shërbimet mjekësore – përvoja e romëve në sistemin shëndetësor

Raportet e ndërmjetësve kanë dokumentuar një sërë shkeljesh të të drejtave të njeriut, të cilët i kanë përjetuar romët gjatë përpjekjeve të tyre për të siguruar shërbime mjekësore. Diskriminimi i përhapur skajshmërisht jo vetëm që rezulton në pranimin e shërbimeve shëndetësore joadekuate, por ndikon në mosdashjen e tyre për t'iu drejtuar këtyre shërbimeve në të ardhmen, madje edhe kur nevojat e tyre janë urgjente.

Në një komunë, pasi që një vajzë e vogël rome kishte gëlltitur një monedhë, e ëma e saj menjëherë e çoi te mjeku lokal, përgjigja e të cilit menjëherë ishte mospërfillëse: fëmijët shpeshherë gëlltisnin gjërësende, tha mjeku, ndërsa monedha tashmë është në barkun e fëmijës, kështu që do ta nxjerrë jashtë më vonë. Mirëpo, vajza dukej që kishte probleme me frymëmarrjen dhe e ëma këmbënguli që të bëjnë një inçizim me radioskopi që të shikoj se ku gjendet monedha. Mjeku refuzoi ta bëjë atë duke thënë që e ëma e vajzës vetëm po krijon panik: në ndërkohë, ajo e dëgjoi njëherë nga motrat mjekësore të thotë, 'Ky është një rast i zakonshëm i 'maxhupëve' – ajo mendon se është më e zgjuar se mjeku.' Pas një debati të gjatë, vajza filloi të vjellë, ndërsa e ëma më në fund e bindi mjekun që të bëjë një radioskopi. Duke u bazuar në rezultatet mjekësore, mjeku kuptoi që monedha gjendej në fytnin e vajzës dhe menjëherë u transferua në spitalin kryesor të Shkupit, ku përfundimisht e nxorrën monedhën.

Në një rast tjetër, një grua rome ishte shtatzënë në muajin e pestë kur i kishte thënë gjinekologu, gjatë kontrollit të rregullt, që fetusi ishte i vdekur dhe ndoshta foshnja ka vdekur 6 javë më parë. Mjeku e referoi te një nga spitalet e Shkupit. Në spital, asaj i ishte mohuar përkujdesja e menjëhershme sepse nuk mund të paguante për të: vetëm pas pranimit të testit të gjakut, i cili tregoi se ajo ishte në gjendje kritike, pranoi përkujdesje të përshtatshme mjekësore. Pas kësaj, ajo ishte e shtrirë në spital për shtatë ditë për t'u shëruar nga infeksioni i gjakut si rrjedhojë e abortit spontan. Të gjitha dokumentet e saja (letër-njoftimi, karta e sigurimit shëndetësor) u sekuestruan nga spitali sepse ajo nuk ishte në gjendje të paguaj 110 euro për koston e trajtimit të saj, ndërsa i kishin thënë që nuk do t'i merr dokumentet derisa ta bëjë pagesën. Gruaja dëshironte të dijë pse fetusi kishte vdekur, mirëpo personeli mjekësor nuk i kishte siguruar asnjë informacion.

Në një rast tjetër, ndërmjetësit romë raportuan për një rast në të cilin gjatë punës sezonale një burrë romë kishte rënë nga traktori dhe kishte përjetuar lëndim në kokë. Pasi që e kishin transferuar në spital, njëri nga mjekët filloi t'ia qepte plagën e kokës, mirëpo kur i mbaroi turni i punës, ai thjeshtë iku, ndërsa pacientit ende i kishte mbetur gjilpëra në kokë. Kur erdhi mjeku i ri, ai kërkoi që pacienti të paguaj për këtë trajtim para se t'ia qepte plagën e kokës: qepja e plagës u krye me sukses vetëm pasi u krye pagesa prej 100 eurove.

## Përfundim

Gjetjet që janë evidentuar nga ndërmjetësit tanë, të mbështetura nga të dhëna dhe raporte të botuara nga një llojllojshmëri e organizatave të pavarura, demonstrojnë se si romët në Maqedoni – edhe përkundër ekzistimit të dispozitave të ndryshme ligjore që e ndalojnë diskriminimin – vazhdojnë të përjetojnë stigmatizim dhe paragjykime që nga moshën e hershme. Këto çështje shpeshherë janë të gërshetuara. Segregimi nëpër shkolla dhe cilësia e dobët e mësimdhënies kontribuojnë në norma të larta të braktisjes së shkollimit; kjo rrjedhimisht e bën të vështirë për romët e rinj të gjejnë punë, të mbështeten në sigurimin social; nivelet e larta të papunësisë dhe burimet e kufizuara e detyrojnë pjesën dërmuese të tyre të jetojnë në kushte strehimi të standardeve të ulta; ndërsa mungesa e energjisë elektrike, uji i pijshëm i sigurt dhe kanalizimi rezultojnë në shëndet të dobët, e cila gjë së bashku me diskriminimin për të pasur qasje në shërbime publike, përfundimisht shpie në jetëgjatësi më të ulët. Aktualisht, përveç një progresi të caktuar në disa fusha, romët vazhdojnë të përjetojnë diskriminim të vazhdueshëm gjatë tërë jetës së tyre dhe mesatarisht vdesin më herët se sa moshatarët e tyre jo romë.

Prandaj, pushteti qendror dhe lokal duhet të marrin masa të fuqishme për të tejkaluar pengesat ekzistuese dhe për të siguruar që dispozitat ligjore mbi ndalimin e diskriminimit të jetësohen plotësisht. Avokati i Popullit, aktivistët romë dhe shoqëria qytetare luajnë një rol të rëndësishëm për tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve rreth mospërputhjeve në ligj dhe praktikë. Qeveria duhet të këshillohet me organizatat qytetare që punojnë me komunitetet romë, me aktivistët romë dhe ndërmjetësit romë – ata që kanë më shumë njohuri për vështirësitë dhe shkeljet e të drejtave në adresë të romëve – për të gjetur zgjidhje konkrete për çështjet me të cilat ballafaqohen romët. Përveç këshillimit, vendimmarrësit kombëtar dhe lokal duhet të përfshijnë përfaqësuesit e romëve në procesin e vendimmarrjes në të gjitha fushat relevante për ata. Rëndësi shumë të madhe ka ajo që romët të rifitojnë besimin në institucionet e shtetit që në mënyrë konstruktive të kontribuojnë në politikat që janë relevante për ata: drejtësia sociale dhe barazua për të gjithë mund të arrihen vetëm me pjesëmarrjen aktive të romëve në të gjitha fushat e jetës publike.



# Rekomandimet

## Arsimi

- Të zhvillohen politika shtetërore për të avancuar vijimin e mësimin parashkollor në mesin e romëve dhe për të ngritur ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së tij në mesin e prindërve.
- Të zbatohet një strategji që në mënyrë efektive të përballohet norma e lartë e braktisjes së shkollimit të mesëm, të cilat do të shtrihen përtej masave ndëshkuese si gjoha ër prindërit për motivimin aktiv të fëmijë romë për të vijuar mësimin shkollor.
- Të vlerësohet numri i fëmijëve romë në zonat e mbulimit të çdo shkolle dhe të sigurohet shpërndarja e tyre e barabartë me fëmijët jo romë.
- Të sigurohet zbatimi i plotë i mundësive për studentët romë për të studiuar gjuhën dhe kulturën rome si lëndë zgjedhore, në pajtim me dispozitat ligjore mbi arsimin.
- Të ndryshohet Neni 156 i Ligjit për Arsimin Fillor që të thjeshtësohet njohja e dëftesave të fituara në shkolla të huaja nga fëmijët që kthehen nga vendet e jashtme. Për më tepër, të hiqet pagesa e tarifës administrative për ato familje që nuk mund të paguajnë ato tarifa për njohjen e dëftesa të shkollave të huaja.
- Të futet një komponentë për mos-diskriminim dhe trajtim të barabartë në plan programet e mësimdhënësve. Përfundimi i shkollimit të bëhet i detyrueshëm për të pranuar me sukses dëftesën e mësimdhënësit.
- Të rishikohen materialet mësimore dhe plan programi për të siguruar mospërfshirjen e stereotipave negative. Nëse është e nevojshme, të përpilohen materiale të reja që e avancojnë trajtimin e barabartë ë romëve dhe minoriteteve tjera.

## Strehimi

- Të kryhen vlerësime të nevojave dhe grumbullimi i të dhënave rreth gjendjes së strehimit të popullsisë rome.
- Të përshpejtohet procesi i legalizimit të objekteve të paligjshme të romëve, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Objekteve të Ndërtuara pa Leje.
- Të krijohen plane urbanistike detale dhe të sigurohen mjete financiare për të përmirësuar infrastrukturën e shërbimeve publike në vendbanimet dhe komunat rome.
- Të identifikohen familjet më të rrezikuara rome dhe të sigurohet strehim sociale për ata.

## Shëndetësia

- Të grumbullohen të dhëna të zërthyera mbi shëndetësinë për të identifikuar pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen romët gjatë qasjes së tyre në shëndetësi me qëllim hartimin e politikave.
- Të ngritet ndërgjegjësimi rreth rëndësisë së shëndetësisë dhe të drejtave të romëve për shërbimet publike nëpërmjet ndërmjetësve romë të shëndetësisë dhe qasjeve tjera alternative, duke i kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të romëve analfabetë.
- Nëpërmjet masave të veçanta, të sigurohet që një numër i caktuar i studentëve romë të bëhen profesionistë të shëndetësisë për të pasqyruar përqindjen e romëve në shoqëri.
- Të rritet numri i ndërmjetësve të shëndetësisë në komunat në të cilat dendësia e popullsisë rome është e lartë duke siguruar më tepër burime për të mbështetur punën e tyre.
- Të sigurohen shërbime shëndetësie falas për romët që nuk kanë dokumente personale, të cilët ndryshe do të kishin qasje të kufizuara në shëndetësi.
- Të stimulohen gjinekologët nëpërmjet granteve të dizajnuara për të synuar shërbimet e shëndetësisë në vendbanimet rome.
- Të mbështetet sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi në mesin e personelit mjekësor mbi mosdiskriminimin, paragjykimet shoqërore dhe barazinë.

# Shënime

- 1 Këshilli i Evropës, 'Dokument i përgatitur nga Ekipi Mbështetës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Çështjet e Romëve', korrik 2012.
- 2 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në 17 nëntor 1991, e ndryshuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit në 16 nëntor 2001.
- 3 Qeveria e Maqedonisë, Strategjia për Romët në Republikën e Maqedonisë, dhjetor 2004.
- 4 Qeveria e Maqedonisë, Strategjia për Romët në Republikën e Maqedonisë (2014 -2020), qershor 2014.
- 5 Komisioni Evropian, *Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Raporti i v. 2018*, Strasburg, prill 2018, fq.33.
- 6 Në qershor 2017, MRG dhe RDDA SONCE e themeluan Rrjetin e Romëve për Avokim me pjesëmarrjen e OJQ-ve rome dhe jo rome, si dhe Zyrës së Avokatit të Popullit dhe ekspertëve të kundër diskriminimit.
- 7 Neni 9, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: 'Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat e tyre, pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë kombëtare ose sociale, bidnjeve politike dhe fetare, gjendjes sociale ose të pasurisë. Të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe Ligjit.'
- 8 Neni 4.1, Marrëveshja Kornizë, e arritur në Ohër, Maqedoni, e nënshkruar në Shkup, Maqedoni 13 gusht: 'Parimi i mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë i të gjithëve sipas ligjit do të respektohet tërësisht.'
- 9 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fletorja Zyrtare nr. 50/10.
- 10 Propozim ligji i përmirësuar për Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi do të miratohet së shpejti, i cili mori vlerësim pozitiv nga Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) në mars 2018.
- 11 Neni 24.1, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 12 Neni 2, Dekreti i shpallur për Ligjin e Avokatit të Popullit, nr. 07-4502/1, 10 shtator 2003: 'Avokati i Popullit do të [...] mbrojë të drejtat ligjore dhe kushtetuese të qytetarëve dhe të gjithë personave të tjerë kur të njëjtat shkelen me akte, veprime dhe lëshime nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat tjera që kanë autoritet publik, si dhe do të ndërmer masa dhe veprime për mbrojtjen e parimit të mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe barabartë të pjesëtarëve të komunitetit në organet e administratës shtetërore, njësitë e vetë-qeverisjes vendore dhe në agjencitë dhe institucionet publike.'
- 13 Parashtruesit nuk kanë për detyrim ta deklarojnë përkatësinë e tyre etnike.
- 14 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, Raporti Vjetor, 2017, fq. 152-154.
- 15 Neni 44, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: 'Çdonjëri ka të drejtë për arsim. Arsimi është i qasshëm për çdonjërin me kushte të barabarta. Arsimi fillor është i detyrueshëm dhe falas.'
- 16 Ligji për Arsimin Fillor, Fletorja Zyrtare nr. 103/08, 2008.
- 17 Komisioni Evropian, Prill 2018, fq.31.
- 18 *Ibid.*, fq.78.
- 19 UNDP dhe Banka Botërore, *Roma at a Glance – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, prill 2018.
- 20 CEA dhe Romalítico, *Shadow Report – Zbatimi i Strategjisë së Romëve në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016 dhe 2017*, mars 2018, fq.62.
- 21 UNDP dhe Banka Botërore, *op. cit.*
- 22 *Ibid.*
- 23 Neni 46, Ligji për Arsimin Fillor, Fletorja Zyrtare nr. 103/08, 2008. Shih po ashtu IHR dhe ERRC, *Segregimi i Fëmijëve Romë në Shkollat të Mesme në Republikën e Maqedonisë*, tetor 2016, fq. 8-9.
- 24 Shih, për shembull, raportin e Avokatit të Popullit, 'Informacione rreth gjendjes së regjistrimit të romëve në klasë të parë dhe përfaqësimi i tyre në klasa të bashku me fëmijët e etniteteve tjera 2014/15', tetor 2015.
- 25 OSF, REF dhe UNICEF, *Përfshirja e Fëmijëve Romë në Moshë të Hershme*, 2012, fq.41.
- 26 CEA dhe Romalítico, *op. cit.*, fq.64. Shih po ashtu IHR dhe ERRC, 'Çështjet me të cilat ballafaqohen studentët romë gjatë reintegrimit të tyre në sistemin arsimor pas kthimit nga vendet e Evropës Perëndimore', dhjetor 2017.
- 27 Ligji për Strehimin nr. 99/09, 05.08.2009.
- 28 Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje nr. 23, 24.2.2011.
- 29 Qeveria e Maqedonisë, *Strategjia Kombëtare për Zbutjen e Varfërisë dhe Gjithëpërfshirjen Sociale në Republikën e Maqedonisë 2010-2020*, mars 2010, fq.66.
- 30 UNICEF, *Përfshirja e të Gjithëve Romëve në Sistemin e Sigurimit Shëndetësor*, 2016, f.2.
- 31 Këshilli i Evropës, Raport Tematik nga Ekspertët e grupit tematik CAHROM për Strehimin Social të Romëve, CAHROM (2012)8, Strasburg, 28 nëntor 2012.
- 32 *Ibid.*
- 33 CEA dhe Romalítico, *op. cit.*, fq.62.
- 34 *Ibid.*, fq. 62-63.
- 35 Neni 39, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: 'Çdo qytetari i garantohet e drejta për përkujdesje shëndetësore. Qytetarët kanë të drejtë dhe obligim ta mbrojnë dhe avancojnë shëndetin e tyre dhe shëndetin e të tjerëve.'
- 36 Neni 9, Ligji për Mbrojtjen Shëndetësore, Fletorja Zyrtare nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013.
- 37 Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve, Fletorja Zyrtare nr. 82/2008, 12/2009 dhe 53/2011.
- 38 Ligji për Sigurimin Shëndetësor, Fletorja Zyrtare nr.25/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 16/2013, 91/2013 dhe 187/2013).
- 39 Komisioni Evropian, prill 2018, *op. cit.*, fq.33.
- 40 UNDP dhe World Bank, *op. cit.*
- 41 ECE, OSF dhe FOSM, *Të Gjithëve Jemi Njerëz: Përkujdesje Shëndetësore për të Gjithëve Njerëzit pa Dallim të Etnitetit të Tyre*, 2014, fq.9.
- 42 UNICEF, *Gjithëpërfshirja e të Gjithëve Romëve në Sistemin e Sigurimit Shëndetësor*, 2016, fq.2.
- 43 OSF, REF dhe UNICEF, *op. cit.*, fq.24.
- 44 ECE, OSF dhe FOSM, *op. cit.*, fq.37.
- 45 *Ibid.*, fq.38.
- 46 Programi i ndërmjetësve romë për shëndetësi është realizuar që në vitin 2011, i financuar nga Ministria e Shëndetësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni dhe Shoqata e Shëndetësisë, Arsimit dhe Hulultimit (HERA). Në kuadër të projektit, 16 ndërmjetës të aftësuar dhe akredituar punojnë në tetë komuna në të cilat dëndësia e popullsisë rome është më e lartë. Shih European Social Policy Network, Roma Health Mediators në Maqedoni: një model i suksesshëm në rrezik?, ESPN Flash Report 37/2017, qershor 2017,.
- 47 CEA dhe Romalítico, *op. cit.*, fq.64.
- 48 ECE, OSF dhe FOSM, *op. cit.*, fq.10.





## **Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë**

Andrea Spítálszky

Popullsia rome e Republikës së Maqedonisë ende është minoriteti më i cenueshëm në vend; një komunitet që përballet edhe me marginalizim institucional edhe me paragjykim sociale. Ky raport, duke u mbështetur në të dhëna të dorës së parë, të cilat u grumbulluan nga ndërmjetësit romë që punonin me komunitetet e tyre, ofron njohuri thelbësore për jetën e tyre të përditshme dhe vështirësitë me të cilat vazhdojnë të përballen.

Pavarësisht nga njohja zyrtare, romët ende mbeten të përjashtuar nga shoqëria kryesore dhe përjetojnë diskriminim në pothuajse çdo pikëpamje të jetës së tyre, duke filluar nga shkollat e deri në jetën e tyre madhore, ku pjesa dërmuese e romëve nuk janë në gjendje të fitojnë punësim zyrtar. Rrjedhimisht, shumë romë jetojnë në kushte jetesë nën standardet, shpeshherë duke luftuar me mbipopullimin dhe pa qasje në shërbime themelore.

Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë paraqet një sërë sfidash me të cilat ende ballafaqohen romët e vendit, si dhe përfshin një seri rekomandimesh për atë se si mund të përmirësohet gjendja e tyre. Këto përfshijnë një qasje më gjithëpërfshirëse në ofrimin e shërbimeve, ndërgjegjësim më të madh për disa pengesa që i përjetojnë komuniteti, si dhe vihet theksi në strategjitë e synuara për të adresuar pabarazitë.

### **© Minority Rights Group International, nëntor 2018**

**Minority Rights Group International (MRG)** është organizatë joqeveritare (OJQ) që vepron në sigurimin e të drejtave të minoriteteve etnike, fetare dhe linguistike si dhe popujve indigjen anembanë botës, si dhe avancimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve. MRG ka status konsultativ në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), si dhe statusin e vëzhguesit në Komisionin Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve. MRG është regjistruar si shoqëri bamirëse me nr. 282305 dhe me përgjegjësi të kufizuara sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar me nr. 1544957.

Ky raport është botuar si një kontribut për të kuptuarit publik.

Teksti nuk e përfaqëson domosdoshmërisht, në çdo hollësi, pikëpamjen kolektive të MRG-së ose partnerëve të tij. Kopje të këtij hulumtimi janë të qasshme në internet në: [www.minorityrights.org](http://www.minorityrights.org)

**Minority Rights Group International** 54 Commercial Street, London E1 6LT, United Kingdom

**Tel** +44 (0)20 7422 4200 **Fax** +44 (0)20 7422 4201 **Email** [minority.rights@mrgmail.org](mailto:minority.rights@mrgmail.org)

**Uebfaqe** [www.minorityrights.org](http://www.minorityrights.org)  [www.twitter.com/minorityrights](https://www.twitter.com/minorityrights)  [www.facebook.com/minorityrights](https://www.facebook.com/minorityrights)